

**RREGULLAT MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT  
ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDOR**

**PJESA E PARË**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**NENI 1**

**Qëllimi**

Këto rregulla kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klienteve të gazit natyror, përmes vendosjes së kushteve të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të Licencuarit në Aktivitetin e Furnizimit në Sektorin e Gazit Natyror.

**NENI 2**

**Baza ligjore**

Këto rregulla hartohen në mbështetje të:

- Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 75, neni 95, neni 96;
- Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konusmatorëve”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014.

**NENI 3**

**Përkufizime**

Disa nga shprehjet e përdorura në këto rregulla do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

- 1. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE”** - është institucioni Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.
- 2. “Person”** - do të thotë çdo person fizik ose juridik, Qeveria ose çdo agjensi shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji brenda dhe jashtë vendit, përveç ERE.
- 3. “Klient fundor”** - është një klient që blen gaz natyror vetëm për përdorim vetjak.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

4. **“Klient i mbrojtur”** janë klientët familjarë e klientët e vegjël jofamiljarë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes së gazit, shërbimet kryesore sociale të lidhura me rrjetin e shpërndarjes e të transmetimit, si dhe ngrohja me gaz në bllok e godinave, për aq kohë sa furnizojnë klientët e sipërpërmendur, që mjafton të provojë se këto impiante nuk mund të operojnë me lëndë të tjera djegëse dhe se janë të lidhura me një rrjet gazi transmetimi apo shpërndarjeje.
5. **“Kërkesë”** - do të thotë një kërkesë me shkrim e paraqitur në ERE, nga një person për një çështje, që është objekt i rregullimit nga ERE.
6. **“Aplikues”** - do të thotë çdo person, i ndryshëm nga ankuesi, i cili kërkon të fillojë një veprim që kërkohet të institucionalizohet nga aplikimi.
- 7 **“Ankues”** - do të thotë një person që depoziton një ankesë në ERE, për çdo veprim ose mosveprim të një personi, që është në juridiksionin e ERE-s për aktivitetin që kryen, siç parashikohet në Ligjin Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror ”.
8. **“I ankimuar”** - do të thotë një person, kundër të cilit është paraqitur një ankesë ose ka filluar një hetim nga ERE.
9. **“Palë e interesuar”** - do të thotë një person që merr pjesë ose synon të marrë pjesë në çdo marrëdhënie në sektorin e gazit natyror të Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe akte të tjera ligjore në fuqi.
10. **“Tarifat dhe çmimet”** - janë pagesat që duhet të kryhen nga Klientët për shërbimet e gazit natyror, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE që ushtrojnë veprimtari të rregulluar në sektorin e gazit natyror. Tarifat dhe çmimet e gazit natyror mund të rishikohen nga ERE me propozim të të licencuarve ose me iniciativën e vet ERE, sipas parimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
11. **“Tarifë e ndërprerjes së kontratës”** - është tarifa e cila paguhet nga Klienti ndaj Furnizuesit, në rastin kur kërkon ndërprerjen e furnizimit në pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, sipas kontratës së furnizimit me gaz natyror. Kjo tarifë nuk është e aplikueshme, në rastin kur Klienti ndërpret kontratën e furnizimit me gaz natyror për të ndryshuar Furnizuesin.
12. **“Terma dhe kushte”** - do të thotë dispozita të miratuara nga ERE ndaj një të licencuari, që siguron një ose disa shërbime në sektorin e gazit natyror, të cilave do t'i sigurohet shërbimi ose shërbimet e Klienteve.
13. **“Gaz natyror”** - është gazi metan, përshtirë gazin shoqërues, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

14. **“Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)”** - është personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit.

15. **“Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)”** - është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

## **PJESA E DYTË**

### **STANDARTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR**

#### **NENI 4**

##### **Kushtet paraprake të lidhjes së një kontrate të furnizimit me Gaz Natyror**

4.1 Furnizuesi duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme dhe pa pagesë për palët e interesuara, informacionin e nevojshëm me shkrim për procedurat e lidhjes së një kontrate të furnizimit me gaz natyror. Ky informacion duhet të jetë i detajuar, transparent dhe të pasqyrohet dukshëm nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit, duke përfshirë publikime të këtij informacioni edhe në formën e broshurave apo në formë elektronike në faqen e internetit të Furnizuesit, dhe mund të publikohet dhe në website-n e ERE-s.

4.2 Informacioni duhet të jetë në një gjuhë të kuptueshme dhe në një format të aksesueshëm për të gjithë të interesuarit.

4.3 Informacioni duhet të përmbajë minimalisht:

a) Dokumentacionin që duhet të depozitohet aplikuesi në momentin e paraqitjes së kërkesës për lidhjen e Kontratës së Furnizimit me Gaz Natyror; të tilla si:

- vërtetimi i identitetit dhe vendndodhjes; si dhe
- çdo dokumentacion teknik që shërben për realizimin e lidhjes së kontratës.

b) Afatin për trajtimin e kërkesës së aplikuesit për lidhje të një kontrate të furnizimit me gaz natyror;

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

- c) Të drejtat dhe detyrimet e çdo furnizuesi dhe klienti fundor rregullohen sipas kontratës së furnizimit me gaz natyror.
- ç) Vendet apo zyrat ku mund të bëhen ankesat duke përfshirë të dhënat mbi qendrat e kujdesit të klientit, të cilat japin informacion për ankesat, të vendosura nga furnizuesi;
- d) Procedura e paraqitjes së një ankese dhe afatet e trajtimit të saj, konform ligjit;
- dh) Detyrimin e Furnizuesit për mos nxjerrjen e të dhënave personale të klientit, konform ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale”;
- e) Çmimet që aplikohen dhe/ose tarifat e rregulluara për shërbimet e ofruara nga furnizuesi;
- ë) Draft kontrata e furnizimit me gaz e përgatitur nga furnizuesi, sipas nenit 5 të këtyre Rregullave; si dhe
- f) Kërkesat për lidhjen e kontratave të shërbimeve të transmetimit dhe/ose shpërndarjes me gaz natyror, sipas pikave 4.4(b) dhe 4.5 të kësaj rregulloreje.

4.4. Secili furnizues duhet të publikojë në faqen e vet një listë të caktuar të informacionit dhe dokumenteve që duhet të dorëzohen nga klienti fundor së bashku me kërkesën e tij për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz. Informacioni dhe dokumentet e kërkuara nga furnizuesi duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto rregulla dhe nuk do të shkaktojnë ndonjë kufizim ndaj klientëve fundor për të përfunduar kontratën e furnizimit me gaz.

4.5. Çdo klient fundor, para përdorimit të rrjetit të konsumit të gazit natyror, duhet të sigurojë që shërbimet e tij ose objekte të tjera janë të lidhura me rrjetin e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së gazit natyror, sipas termave dhe kushteve të vendosura në kodin e rrjetit që aplikohet dhe duhet të lidhë një:

- a) kontratë të furnizimit me gaz me furnizuesin, sipas Ligjit Nr. 102/2015 “Për Gazin Natyror” dhe këtyre rregullave; dhe
- b) kontratë për shërbimet e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së gazit me operatorin (ose Operatorët) e sistemit në funksion, në varësi të rrjetit të gazit natyror tek i cili shërbimet ose objekte /ndërtesat e tjera të klientit fundor që janë lidhur, sipas Ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kodeve të rrjetit që aplikohen.

4.6. Pa rënë në kundërshtim me pikën 4.5(b), secili klient fundor mund të dakordësojë që furnizuesi të lidhë kontratën mbi transmetimin dhe/ose shpërndarjen e gazit natyror në emër të klientit fundor, me kushtin që furnizuesi aktual ta ofrojë këtë shërbim sipas marrëveshjeve përkatëse me operatorët përgjegjës të sistemit.

### NENI 5

#### **Forma dhe përmbajtja e kontratës së furnizimit me gaz natyror.**

5.1. Kontrata e furnizimit me gaz natyror lidhet në një format të ofruar nga furnizuesi, përveç rasteve kur kontrata standarte e furnizimit lidhet me një format të miratuar nga ERE, sipas Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Çdo furnizues duhet të jetë i detyruar të përgatisë një format të standartizuar të kontratës së furnizimit me gaz dhe duhet ta publikojë atë në faqen e

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

internetit ose kur kontrata standarte e miratuar nga ERE është e aplikueshme, ta publikojë në faqen e internetit.

5.2. Kontrata e furnizimit duhet të paktën të përmbajë sa më poshtë:

a) identitetin e furnizuesit, përfshirë emrin e kompanisë, numrin tregtar të regjistrimit, adresën zyrtare, numrin e licencës së furnizimit të gazit natyror dhe datën e lëshimit të saj, detajet e kontaktit (adresën për korrespondencën, numrin e telefonit, adresën e e-mail-it dhe të faqes së internetit, etj) si dhe përfaqësuesit e tij të autorizuar për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror dhe bazën ligjore për autorizimin përkatës (p.sh Statutet, aktet e tjera të përfshira dhe autorizimet);

b) identitetin e klientit fundor:

- klientin jo familjarë: emrin e kompanisë, numrin tregtar të regjistrimit, adresën zyrtare, detajet e kontaktit (adresën për korrespondencën, numrin e telefonit , adresën e e-mail-it , faqen e internetit, *etj.*), si dhe përgjegjësit e tij të autorizuar për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror dhe bazën ligjore për autorizimin përkatës (*p.sh.* Statutet, akte të tjera të përfshira dhe autorizimet);

- klientët familjarë: emri, mbiemri, data e lindjes, banimi, detajet e kontaktit (adresa për korrespondencën, numri i telefonit, adresa e e-mail-it, *etj.*);

c) vendin dhe të dhënat përkatëse për shërbimet ose objektet e tjera për klientët fundor tek i cili do të furnizohet gazi natyror, përfshirë detajet teknike të këtyre shërbimeve ose objekteve të tjera dhe të pikave të tyre matëse;

ç) informacion në lidhje me kontratat e lidhura nga klientët fundor me operatorin e sistemit, për shërbimin e furnizimit të objekteve të tjera me gaz natyror;

d) informacion mbi kontratat e lidhura nga klientët fundor me operatorin (operatorët) e sistemit, për shërbimet e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së gazit natyror, si dhe: kur mund të aplikohen këto kontrata, autorizime të furnizuesit për të lidhur këto kontrata në emër të klientit fundor;

dh) detyrimet e palëve kontraktore, objektin dhe fushën e tyre si dhe shërbimet e ofruara nga furnizuesi, përfshirë nivelet e ofruara të shërbimit të cilësisë së ofruar;

e) kushtet në lidhje me cilësinë e furnizimit të gazit natyror në pikën e matjes;

ë) çmimet e gazit natyror të aplikuar për klientin fundor;

f) metodat për llogaritjen, faturimin dhe pagesat e gazit natyror të konsumuar;

g) metodat për sigurimin e informacionit të përditësuar mbi shërbimet e ofruara nga furnizuesi dhe mbi çmimet e gazit natyror që aplikohen për klientin fundor;

gj) të dhënat e kontaktit për personat e autorizuar dhe të qendrave të kujdesit të klientit, përfshirë oraret e tyre të punës, kur klienti fundor do të jetë në gjendje të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për zbatimin e kontratës së furnizimit me gaz natyror;

h) informacion në lidhje me të drejtat e klientit;

i) përgjegjësi lidhur me moszbatimin e detyrimeve të ndërmarra nga palët kontraktore;

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

j) afatet dhe kushtet për kompensimin e humbjeve të shkaktuara si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve të ndërmarra nga palët kontraktore;

k) afatet dhe kushtet për trajtimin e ankesave të klienteve fundorë si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve kontraktore, sipas Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; dhe

l) afatin për vlefshmërinë e kontratës së furnizimit me gaz natyror, afatet dhe kushtet për ndryshimin, rinovimin dhe përfundimin e saj, përfshirë informacionin nëse klienti fundor ka të drejtën për të përfunduar kontratën pa penalitete financiare ose masa të tjera kufizuese.

5.3. Pa rënë në kundërshtim, në pikën 5.2 të kësaj rregulloreje, kontratat e furnizimit me gaz nga furnizuesi sipas detyrimit të shërbimit publik për klientët familjarë dhe bizneset e vogla duhet të përputhen me kontratën tip të furnizimit të miratuar nga ERE. Përmbajtjet e kontratave respektive mund të modifikohen ose në të kundërt të ndërhyhet nga palët kontraktore vetëm në rastet me vendim të ERE-s, sikurse përcaktuar në Nenin 7 të kësaj Rregullore.

5.4. Pa rënë në kundërshtim me pikën 5.2, kontratat e shërbimit me gaz nga furnizuesi i mundësisë së fundit, mund të parashikojë afatet dhe kushtet specifike sipas furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror, konform Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe rregullave operacionale të furnizuesit të mundësisë së fundit, të miratuara nga ERE.

5.5. Aktet ligjore në fuqi mund të përcaktojnë terma dhe kushte të veçanta duke përfshirë dispozitat standarte të detyrueshme për kontratat e furnizimit me gaz natyror që lidhen me klientët fundor në nevojë.

5.6. Dispozitat e kontratës së furnizimit me gaz duhet të jenë të drejta, proporcionale, të qarta dhe të kuptueshme, dhe duhet të aplikohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të kenë pengesa në ushtrimin e të drejtave të klientit fundor dhe nuk duhet të paraqesin metoda të padrejta ose ç’orientuese të shitjes, matjes, faturimit dhe/ose pagesës.

5.7. Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të përmbajnë dispozita që mund të parandalojnë ose pengojnë klientin nga ndërprerja e njëanshme e kontratës, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këto Rregulla dhe/ose ndryshimi pa pagesë i furnizuesit sipas rregullave të ndryshimit të furnizuesit, të miratuara nga ERE.

5.8. Përmbajtjet e kontratës së furnizimit me gaz duhet të publikohen paraprakisht dhe ti bëhet e njohur klientit. Kjo kërkesë do të aplikohet edhe në rastet kur kontrata e furnizimit me gaz lidhet përmes ndërmjetësve.

**NENI 6**

**Lidhja e kontratës së furnizimit me gaz**

- 6.1. Aplikanti duhet ta paraqesë aplikimin me shkrim ose në mënyrë elektronike tek furnizuesi për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz, sikurse përcaktohet nga furnizuesi, në mënyrë që të mundësojë identifikimin e personit i cili po aplikon për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz.
- 6.2. Së bashku me aplikimin për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror, aplikanti duhet ti paraqesë furnizuesit dokumentat të cilat provojnë identitetin e tij, të dhënat dhe dokumentat në lidhje me shërbimet ose objektet e furnizimit me gazit natyror të aplikantit dhe informacione dhe dokumenta të tjera që kërkohen nga furnizuesi, sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje.
- 6.3. Aplikanti i cili kërkon të lidhë marrëveshjen për furnizimin me gaz natyror, duhet të informohet nga furnizuesi për pranimin ose jo të aplikimit të tij, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga paraqitja e aplikimit së bashku me informacionin dhe dokumentat e nevojshme, siç kërkohet në pikat 6.1 dhe 6.2 të këtij neni.
- 6.4. Nëse kërkesa e aplikantit nuk shoqërohet me informacionin e plotë dhe/ose dokumentacionin që kërkohet nga furnizuesi, ky i fundit brenda shtatë (7) ditëve, duhet të informojë aplikantin për informacionin dhe/ose dokumentacionin e munguar.
- 6.5. Aplikanti duhet ta paraqesë informacionin dhe/ose dokumentacionin e munguar brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa duhet të refuzohet nga furnizuesi nëse informacioni dhe/ose dokumentacioni i dhënë nga aplikanti nuk është i plotë. Furnizuesi duhet të njoftojë aplikantin në çdo rast për miratimin ose jo të kërkesës së tij. Çdo refuzim nga furnizuesi duhet të justifikohet dhe duhet ti shpjegohet me shkrim klientit.
- 6.6. Në rastet kur aplikimi për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror pranohet nga furnizuesi, draftet e propozuara të kontratës së furnizimit me gaz duhet të përgatiten nga furnizuesi, sipas Nenit 5 të këtyre rregullave dhe ti paraqiten aplikantit jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 6.3 të këtij neni.
- 6.7. Propozimi për kontratën e furnizimit me gaz natyror nga furnizuesi dhe të gjitha informacionet ofrohen pa pagesë, siç kërkohet nga këto Rregulla. Ky propozim duhet të përmbajë afatin e vlefshmërisë së tij, që në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se tre (3) javë pas datës së propozimit. Vlefshmëria e propozimit për kontratën e furnizimit me gaz natyror duhet të lidhet me klientin familjarë dhe nuk duhet të jetë e kufizuar në kohë.
- 6.8. Furnizuesi duhet të jetë përgjegjës për informacionin e dhënë ndaj klientit fundor, përfshirë këtu afatet dhe argumentat ligjor.
- 6.9. Paraqitja e propozimit për kontratën e furnizimit me gaz natyror, në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet si vendosje e ndonjë detyrimi për klientin fundor që të lidhë kontratën e furnizimit me gaz me këtë furnizues të veçantë, që do të thotë se klienti fundor ka të drejtë të pakushtëzuar për të kundërshtuar draftin e propozuar të furnizuesit për kontratën e furnizimit me gaz natyror.
- 6.10. Pas marrjes së propozimit nga furnizuesi për kontratën e furnizimit me gaz natyror, duke parë afatin e vlefshmërisë, siç përcaktuar në pikën 6.7 të këtij neni, klienti fundor mund të firmosë kontratën ose mund ta kundërshtojë atë, duhe informuar furnizuesin.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

6.11. Me nënshkrimin e kontratës së furnizimit me gaz natyror, klienti fundor konfirmon që shërbimet dhe objektet e tij tek të cilat do të furnizohet gazi natyror, janë në pronësi të atij klienti ose ka të drejtën për të menaxhuar shërbimet ose objektet e tjera, duke përfshirë të drejtat e qiramarrjes dhe/ose të administrimit të pronës dhe të lidhë kontratën e furnizimit me gaz. Nëse kërkohet nga furnizuesi, klienti fundor duhet të sigurojë dokumentat të cilat evidentojnë të drejtat respektive, përfshirë kur është e nevojshme, pranimin e zotëruesit të shërbimeve ose objekteve të tjera për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz.

6.12. Kontrata e furnizimit me gaz natyror në emer të grupit të klientëve fundorë ose bashkëpronareve në një pikë matje me të njëjtin konsum, duhet të lidhet nga personi i autorizuar me shkrim nga ky grup ose bashkëpronarë të tjerë, sipas akteve ligjore në fuqi.

6.13. Klienti fundor i cili ka disa pika matje, duhet të lejohet të lidhë një kontratë të veçantë të furnizimit me gaz natyror për çdo pikë matje ose për disa pika matje me identifikim për çdo pikë matje të dhënë, sipas kontratës respektive të furnizimit me gaz.

6.14. Në rastet kur kontrata e furnizimit me gaz mbulon lidhjen e kontratave të transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së gazit natyror, sipas pikës 4.6, klienti fundor dhe furnizuesi duhet të bien dakord që kontrata e furnizimit me gaz natyror hyn në fuqi në ditën kur shërbimet ose objektet e klientit do të lidhen në rrjetin e gazit natyror, por jo më vonë se dita e instalimit të pikës (pikave) matëse. Në raste të tjera, kur shërbimet ose objektet e tjera lidhen me rrjetin e gazit natyror, kontrata e furnizimit me gaz hyn në fuqi në datën e rënë dakord midis klientit dhe furnizuesit, që do të jetë edhe data e hyrjes në fuqi e kontratës për transmetimin dhe/ose shpërndarjen e gazit natyror midis furnizuesit dhe operatorit të sistemit në detyrë.

6.15. Furnizuesi duhet të informojë operatorin e sistemit në detyrë për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror, jo më vonë se dita tjetër e punës pasi klienti fundor nënshkruan kontratën dhe njofton furnizuesin.

### **NENI 7**

#### **Ndryshimet në kontratën e furnizimit me gaz**

7.1. Furnizuesi duhet të njoftojë klientët e tij fundorë për ndryshimet në kontratën e furnizimit me gaz, përfshirë ndryshimet e çmimit të gazit natyror. Ky njoftim duhet të paraqitet me shkrim dhe/ose me e-mail, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para se këto ndryshime të hyjnë në fuqi, dhe duhet të shpjegohet qartë që klienti fundor ka të drejtën ti kundërshtojë këto ndryshime dhe të përfundojë kontratën e furnizimit me gaz pa pagese ose kufizime të tjera, sipas këtyre Rregullave.

7.2. Pa rënë në kundërshtim me kërkesat e vendosura në pikën 7.1 të këtij neni, palët kontraktore duhet të dakordësojnë së bashku për ndryshimet në kontratën e furnizimit me gaz natyror, në çdo kohë sipas afateve dhe kushteve të vendosura në kontratën e furnizimit me gaz. Kontrata standarte e furnizimit me gaz e miratuar nga ERE mund të ndryshojë vetëm pas zgjidhjes përkatëse nga ERE, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratën tip.

7.3. Çdo ndryshim në kontratën e furnizimit me gaz, nuk do të përjashtohet nga kërkesat e detyrueshme të përshkuara në nenin 5 të këtyre Rregullave, dhe duhet të pranohet dhe nënshkruhet



## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

nga të dyja palët kontraktore. Ndryshimet tek kontrata e furnizimit me gaz do ti bashkëlidhen si shtojcë kontratës së furnizimit me gaz dhe do të jenë pjesë përbërëse e saj.

### NENI 8

#### **Vlefshmëria, përfundimi dhe ndërprerja e kontratës së furnizimit me gaz natyror.**

8.1. Kontrata e furnizimit me gaz natyror e lidhur ndërmjet furnizuesit dhe klientit hyn në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe, derisa nuk kërkohet të ndryshohet nga aktet ligjore në zbatim ose të miratuara midis palëve kontraktore.

8.2. Në rastet referuar pikës 8.1 të këtij neni, kur afati i vlefshmërisë së kontratës së furnizimit me gaz natyror përcaktohet dhe nuk është informuar asnjë nga palët kontraktore për përfundimin e kontratës, ndryshimet e saj ose përfundimi i propozuar i kontratës së re, para se afati i vlefshmërisë të mbarojë, do të konsiderohet si e rinovuar për të njëjtin afat vlefshmërie sipas të njëjtave kushte, siç janë dakordësuar më parë. Në rast se një nga palët kontraktore propozon lidhjen e kontratës së re, kontrata e vjetër do të vazhdojë të aplikohet dhe palët do të vazhdojnë të rregullojnë marrëdhëniet mes tyre derisa të hyjë në fuqi kontrata e re.

8.3. Kontrata e furnizimit me gaz natyror e lidhur mes furnizuesit të mundësisë së fundit dhe klientit fundor vendoset në fuqi për një afat të caktuar vlefshmërie duke mos tejkaluar periudhën e lejuar prej dy (2) muajsh për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror, siç përcaktuar në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

8.4. Kontrata e furnizimit me gaz mund të përfundojë me iniciativën e klientit fundor, sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:

8.4.1. Secili klient fundor ka të drejtën për përfundimin e njëanshëm të kontratës së furnizimit me gaz pa pagesë, bazuar në një njoftim me shkrim të paraqitur të furnizuesi, të paktën tre (3) javë para përfundimit të kontratës.

8.4.2. Secili klient jo familjar ka të drejtën për përfundimin e njëanshëm të kontratës së furnizimit me gaz bazuar tek kushtet e mëposhtme:

a) Në rast se kontrata e furnizimit me gaz është për një periudhë të pacaktuar, klienti jo-familjar ka të drejtën ta përfundojë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, në çdo kohë pa asnjë pagesë ose kufizime të tjera, bazuar në një njoftim me shkrim paraqitur për furnizuesin, të paktën tre (3) javë para përfundimit të kontratës;

b) Në rastin kur kontrata ka hyrë në fuqi për një periudhë të përcaktuar qartë, klienti jo-familjar ka të drejtën që të përfundojë kontratën në mënyrë të njëanshme në datën e vendosur për mbarimin e saj pa pagesë ose masa të tjera kufizuese; ose

c) Në rast kur kontrata e furnizimit me gaz ka një periudhë të përcaktuar qartë dhe klienti jo familjar dëshiron të ndërpresë kontratën në mënyrë të njëanshme para datës së përfundimit të kontratës, ai duhet të njoftojë furnizuesin sipas afateve dhe kushteve të vendosura në kontratë dhe kur është rënë dakord midis palëve kontraktore duhet të kompensojë furnizuesin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

8.5. Klienti fundor, i cili transferon ose përfundon të drejtën e pronësisë ose të drejtën e zotërimit të ambienteve ose objekteve të tjera të cilat konsumojnë gazin natyror, duhet të njoftojnë furnizuesin jo më vonë se pesë (5) ditë pas kësaj transferte dhe duhet të bien dakord me furnizuesin për përfundimin e kontratës së furnizimit me gaz dhe pagesës për gazin natyror të konsumuar. Në këtë rast klienti fundor ka të drejtën të përfundojë kontratën e furnizimit me gaz pa pagesë ose pengesa të tjera, pavarësisht kushteve të dakordësuara sipas kontratës.

8.6. Në rastet referuar pikës 8.5, pronari i ri ose qiramarrësi ose ndonjë person tjetër i cili merr pronësinë ose posedimin e shërbimeve ose objekteve të tjera të cilat konsumojnë gazin natyror do të aplikojnë tek furnizuesi për lidhjen e kontratës së furnizimit me gaz, sipas termave dhe kushteve të vendosura në këto Rregulla. Personi që dëshiron të lidhjë një kontratë të re të furnizimit me gaz, do të ketë një të drejtë të pakushtëzuar për të aplikuar tek çdo furnizues me përzgjedhjen e tij.

8.7. Kontrata e furnizimit me gaz mund të përfundojë në mënyrë të njëanshme me iniciativën e furnizuesit në rast të shkeljes nga Klienti të detyrimeve të domosdoshme të kontratës. Shkeljet e kushteve të kontratës konsiderohen të nevojshme nga klienti në rastet e mëposhtme:

a) Nëse klienti nuk paguan detyrimet që lindin nga furnizimi me Gaz Natyror, përfshirë kamatvonesat brenda 1 (një) muaji pas ndërprerjes së furnizimit, sipas nenit 16 të këtyre Rregullave.

b) Nëse vërtetohet nga Furnizuesi që Klienti konsumon gazin natyror në mënyrë jo ligjore, që do të thotë në rast të shkeljes së detyrimeve të klienti sipas kushteve për lidhjen e shërbimeve të tij ose objekteve të tjera me rrjetin e gazit natyror, afateve dhe kushteve të matjes për gazin e shpërndarë dhe konsumuar dhe/ose shkeljes së kodit të rrjetit që aplikohet.

c) Nëse klienti, në mënyrë të vazhdueshme nuk i jep akses furnizuesit për më shumë se 3 (tre) muaj për të lexuar dhe verifikuar matesat dhe instalimet, kur matësi ose sistemi matës është jashtë kufijve të pronësisë së tij.

ç) Nëse furnizimi dhe/ose shpërndarja e gazit natyror në ambientet ose objektet e tjera të klientëve ndërpritet, sipas nenit 22 të këtyre Rregullave për shkak të këtyre klientëve, për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj.

8.8. Furnizuesi duhet ti paraqesë klientit fundor njoftimin e tij me shkrim për përfundimin e kontratës së furnizimit me gaz mbi bazat e përshkruara në pikën 8.7 të këtij neni, të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së përfundimit. Furnizuesi duhet të informojë klientin fundor për rezultatet e mundshme të përfundimit të kontratës së furnizimit me gaz, përfshirë shkëputjen e ambjenteve ose objekteve të tjera të klientit fundor nga rrjeti i gazit natyror. Furnizuesi nuk duhet të ndërpresë furnizimin me gaz natyror, në rast se klienti fundor, brenda 30 ditësh pas njoftimit të furnizuesit, korrigjon shkeljet e evidentuar në kontratë dhe ia pasqyron këto korrigjime furnizuesit.

8.9. Klienti fundor dhe furnizuesi mund të vendosin në çdo kohë sëbashku për përfundimin e kontratës së furnizimit me gaz natyror, sipas afateve dhe kushteve të specifikuara në aktet ligjore në fuqi.

8.10. Klienti mund të kërkojë ndërprerjen e marrëveshjes për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij, por në çdo rast jo më vonë se për 12 (dymbëdhjetë) muaj rresht. Klienti duhet të informojë me shkrim Furnizuesin pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike para ditës që ai kërkon ndërprerjen dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet për Furnizuesin, jo më vonë se tridhjetë (30)

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

ditë nga kërkesa për të ndërprerë marrëveshjen. Furnizuesi duhet të ndërpresë furnizimin me gaz natyror sipas procedurave dhe termave të përcaktuara për këtë qëllim, pas njoftimit me shkrim të Klientit për pranimin e kërkesës së tij. Klienti duhet të bëjë kërkesën për ri-lidhje në çdo zyrë të furnizuesit dhe ky i fundit duhet të bëjë ri-lidhjen brenda 48 orëve pas paraqitjes së kërkesës.

8.11. Klienti është përgjegjës për kryerjen e detyrimeve në lidhje me konsumin e Gazit Natyror deri në ndërprerjen e marrëveshjes. Në çdo rast klienti nuk është përgjegjës për detyrimin e furnizuesit pas afatit të caktuar në pikën 8.10 të këtij neni, përveç detyrimit për të paguar furnizuesin për gazin natyror të konsumuar përpara ndërprerjes së kontratës së gazit natyror, dhe kur është e përshtatshme për shërbimet e tjera të ofruara.

8.12. Furnizuesi dhe/ose klienti fundor, në varësi të angazhimeve të dakordësuara sipas kontratës së furnizimit me gaz, duhet të njoftojë operatorin e sistemit në detyrë, jo më vonë se tre (3) javë para datës së përfundimit ose ndërprerjes së kontratës së furnizimit me gaz dhe duhet të japin informacionin e kërkuar sipas kodit të rrjetit dhe kontratave të lidhura me operatorin e sistemit në detyrë.

8.13. Me përfundimin ose ndërprerjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror, Furnizuesi duhet menjëherë të ndërpresë furnizimin me gaz natyror në ambjentet ose objektet e tjera të klientit fundor, dhe kur është e mundur duhet ti kërkojë operatorit të sistemit në detyrë ndërprerjen e shpërndarjes së gazit natyror në ambjentet dhe objektet e tjera të klientit fundor. Ndërprerja për shpërndarjen e gazit natyror mund të mos kërkohet në rastet kur kontrata e gazit natyror ka përfunduar për shkak të ndryshimit të furnizuesit nga klienti fundor sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Per Gazin Natyror” dhe Rregullave për Ndryshimin e Furnizuesit, të miratuara nga ERE. Ndërprerja e shpërndarjes së gazit natyror në ambjentet ose objektet e tjera të klientit fundor duhet të kryhet sipas kodit të rrjetit në fuqi.

8.14. Pas përfundimit ose ndërprerjes së kontratës së furnizimit me gaz, Furnizuesi duhet të lexojë matësit në pikën e lidhjes me ambjentet ose objektet e tjera të klientit fundor dhe duhet të llogarisë faturën finale për furnizimin me gaz natyror të klientit fundor. Fatura përfundimtare duhet të paraqitet nga furnizuesi tek klienti fundor, jo më vonë se njëzet (20) ditë, pas përfundimit ose ndërprerjes së kontratës së furnizimit me gaz, nëse vetë kontrata e furnizimit me gaz nuk mund të ofrohet për një afat me të shkurtër për paraqitjen e faturës përfundimtare.

8.15. Klienti është përgjegjës për kryerjen e detyrimeve në lidhje me konsumin e Gazit Natyror, deri në përfundimin e kontratës. Me përfundimin e kontratës së furnizimit me gaz, klienti fundor duhet ti paguajë furnizuesit gazin natyror të konsumuar para përfundimit të kontratës së furnizimit me gaz, dhe kur është e përshtatshme, për shërbimet e tjera të ofruara në bazë të faturës përfundimtare të paraqitur nga furnizuesi, sipas pikës 8.14. Në çdo rast klienti nuk është përgjegjës për detyrimet ndaj furnizuesit, përveç moskryerjes së pagesës, pas datës së përfundimit të kontratës së furnizimit me gaz.

8.16. Vullneti për të ushtruar të drejtën e heqjes dorë duhet të manifestohet në formë të shkruar, e të përcillet në mënyrën e përcaktuar nga kontrata. Modalitetet e vëna në dispozicion të klientit fundor për ushtrimin e të drejtës së heqjes dorë nga kontrata, duhet të jetë e tillë që të mundësojë verifikimin e marrjes së njoftimit nga furnizuesi, për heqjen dorë nga kontrata.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

8.17. Klienti fundor që mban një kontratë furnizimi dhe ushtron të drejtën për të hequr dorë nga kontrata, për shkak të ndryshimit të furnizesit aktual, ka të drejtë të paraqesë njoftimin e ndërprerjes nga furnizuesi i mëparshëm tek Furnizuesi i ri i zgjedhur prej tij.

8.18. Kur klienti fundor që mban një kontratë furnizimi dhe nuk kërkon heqjen dorë nga kontrata për të ndryshuar operatorin, por kërkon të ndërpresë furnizimin me gaz natyror dhe kontratën që lidhen me të, ai i paraqet kërkesën drejtpërdrejt Furnizuesit me të cilin ka lidhur aktualisht kontratën.

8.19. Periudha për paraqitjen e njoftimeve, sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje, duhet të llogaritet nga dita e parë e muajit të parë, pas marrjes së njoftimeve të terheqjes nga palët kontraktuese.

8.20. Pas njoftimit për lidhjen e kontratës së re të furnizimit me gaz natyror, siç kërkohet në pikën 6.15 të kësaj rregulloreje, kontrata e mëparshme e furnizimit me gaz konsiderohet e përfunduar në datën e përcaktuar nga palët kontraktore.

8.21. Në rastet kur kontrata e furnizimit me gaz përfundon dhe kontrata e re nuk është lidhur ende por klienti fundor vazhdon të konsumojë gaz natyror, gazi natyror duhet të furnizohet në ambientet ose objektet e tjera të këtij klienti fundor nga furnizuesi i mundësisë së fundit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe rregullave operacionale të furnizuesit të mundësisë së fundit, të miratuara nga ERE.

### PJESA E TRETË

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

##### NENI 9

##### **Të drejtat e Furnizuesit**

9.1. Furnizuesi ka të drejtën:

a) të lidh kontratat e furnizimit me gaz natyror për klientët fundor, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, këtyre Rregullave dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

b) të lidh kontratat përkatëse kur është e përshtatshme me operatorët e sistemit aktual, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në kodet e aplikueshme të rrjetit, me qëllim furnizimin e klientit fundor me gaz natyror;

c) të tregtojë gazin natyror me shumicë dhe/ose pakicë duke ju nënshtruar kërkesave paraprake të autorizimit për këto aktivitete, siç kërkohet në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

ç) të nxjerrë fatura dhe të vendosë pagesa për klientët fundor, sipas afateve të përcaktuara në këto Rregulla dhe në kontratat e furnizimit me gaz për:

- furnizimin me gaz natyror sipas kontratës;
- transmetimin dhe/ose shpërndarjen e gazit natyror, sipas pikës 4.6 të kësaj Rregullore.
- ofrimin e shërbimeve ndihmese, kur kjo aplikohet; dhe
- tarifatat e tjera të vendosura nga aktet ligjore në fuqi.

d) të kërkojë rimbursim të dëmeve të shkaktuara nga mosveprimet ose veprat penale të shkaktuara nga klienti fundor;

dh) ti kërkojë operatorit të sistemit aktual, ndërprerjen e shpërndarjes së gazit natyror për ambientet ose objektet e tjera të klientit fundor mbi bazat e specifikuar në këto Rregulla dhe sipas kodit të rrjetit në fuqi.

9.2. Furnizuesi duhet të zoterojë të drejta të tjera, sipas Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të kësaj Rregulloreje, akteve të tjera ligjore në fuqi si dhe kontratës së furnizimit me gaz natyror.

### **NENI 10** **Detyrimet e Furnizuesit**

10.1. Furnizuesi është i detyruar të furnizojë klientin me gaz natyror, sipas marrëveshjes së nënshkruar nga palët në mënyrë të sigurtë, të besueshme dhe efikase, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të këtyre Rregullave dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

10.2. Çdo furnizues ofron informacionin e nevojshëm për klientin fundor në lidhje me të drejtat e tyre dhe mjetet e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky informacion duhet të publikohet në faqen e internetit të furnizuesit, përveç të dhënave që kanë të bëjnë me klientët fundorë individualë dhe duhet të jepet me shkrim për çdo klient individual sipas kërkesës së tij. Informacioni duhet të jepet sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara nga ERE. Ky informacion ofron për klientët fundorë:

- a) njoftimin në mënyrë transparente, për tarifatat, detyrat dhe kushtet standard të aksesit që aplikohen si dhe përdorimin e shërbimeve;
- b) ofrimin e disa mundësive për pagesën e detyrimeve, pa diskriminim për klientët fundorë;
- c) ofrimin e sistemit të parapagimit, i cili duhet të jetë i drejtë dhe të reflektojë konsumin në vlera reale;
- ç) marrjen e informacionit, për mundësinë e ndryshimit pa pagesë të furnizuesit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe në Rregulloren e Ndryshimit të Furnizuesit, miratuar nga ERE;
- d) marrjen e udhëzimeve për zbatimin e procedurave transparente, të thjeshta dhe ekonomike, në lidhje me trajtimin e ankesave të klientëve, nivelin e cilësisë së shërbimit;

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

dh) marrjen e informacionit për konsumin dhe kostot e gazit natyror. Ky informacion është në dispozicion brenda një kohe të caktuar, i cili merr në konsideratë sistemin e matjes të klientit fundor dhe asnjë kosto shtesë për klientin fundor;

e) marrjen e raportit përfundimtar lidhur me konsumin e gazit, jo me vonë se 6 javë nga momenti i ndryshimit të furnizuesit.

10.3. Furnizuesi ka për detyrë që:

a) të krijojë qendra të kujdesit ndaj klientit, të cilat japin informacion për ankesat dhe pyetjet e tyre;

b) të krijojë struktura të veçanta për shqyrtimin e ankesave të klientëve fundorë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në mbrojtje të klientëve;

c) duhet të trajtojë ankesat e klientëve, në lidhje me shërbimet, sipas marrëveshjes për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

10.4. Çdo furnizues mund të furnizojë klientët fundorë vetëm nëse operatori përgjegjës i sistemit, me të cilin klienti fundor ka lidhur instalimet e tij, i konfirmon furnizuesit që klienti përmbush kërkesat për furnizimin e sigurt me gaz natyror.

10.5. Çdo furnizues përgatit dhe publikon programin e tij të veprimit dhe:

a) ndihmon klientët fundorë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të cilat vijnë nga kontaktet dhe kanë për qëllim të parandalojnë ndërprerjen e furnizimit;

b) garanton furnizimin me gaz për klientët fundorë të cilët jetojnë në zona të largëta;

c) ndërmerri masa për nxitjen e prodhimit të gazit natyror nga burimet e rinovueshme të energjisë.

10.6. Furnizuesi informon rregullisht klientin fundor për masat në përmiresimin e eficiencës për konsumin e energjisë përfundimtare.

10.7. Furnizuesi, sipas nenit 17 dhe 18 të këtyre Rregullave, nxjerr faturën në bazë të sasisë së konsumuar të gazit dhe periudhës së faturimit, e cila duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme. Furnizuesi informon rregullisht klientët fundorë, në lidhje me furnizimin e gazit natyror, përfshirë çështjet e ambientit. Informacioni i dhënë nga furnizuesi për klientët fundorë duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi të miratuara nga ERE.

10.8. Furnizuesi duhet ti ofrojë klientit informacion të mjaftueshëm, ku të përshkruhen qartë shërbimet e ofruara, ofertat përkatëse, rrethanat për shkëputjen e shërbimit të furnizimit, si dhe pagesa të tjera në lidhje me shërbimin e furnizimit. Të gjithë klientët kanë të drejtën e tyre për të përfituar të njëjtat kushte furnizimi nga Furnizuesi i përzgjedhur nga ata.

10.9. Furnizuesi duhet të kryejë detyrimet e tjera të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në këto Rregulla, aktet e tjera ligjore në fuqi si dhe në kontratën e furnizimit me gaz natyror.

**NENI 11**  
**Të Drejtat e Klientëve Fundorë**

11.1. Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin dhe ndryshojnë furnizuesin e tyre, me çmime të parregulluara, sipas një marrëveshje furnizimi të lidhur, në përputhje me këto Rregulla. Klienti mund të ndryshojë furnizuesin sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe në Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit, të miratuar nga ERE.

11.2. Klienti fundor ka të drejtë:

- a) të pajiset me gaz natyror në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të këtyre rregullave, akteve të tjera ligjore në fuqi si dhe kontratës së furnizimit me gaz;
- b) të paraqesë një ankesë në ERE, nëse nuk është furnizuar sipas kushteve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe/ose në kontratën perkatëse;
- c) të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jo-diskriminues;
- ç) të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga furnizuesi, sipas nenit 10 të këtyre Rregullave;
- d) të marrë informacionin e plotë për çmimet, tarifat, afatet dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të gazit natyror;
- dh) të përdorë mekanizma të ndryshëm pagese dhe të mbrohet nga metodat e padrejta të faturimit;
- e) të përfitojë nga procedurat e thjeshta dhe transparente për trajtimin e ankesave, të cilat kur është e mundur ofrojnë sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi;
- ë) të paraqesë një ankesë ndaj çdo veprimi të pa-autorizuar, dështimi ose gabimi të furnizuesit dhe të ketë një trajtim të ankesës, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në aktet ligjore në zbatim;
- f) të marrë rimbursim për dëmin e shkaktuar për shkak të detyrimeve të pazgjidhura të furnizuesit, të cilat rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi dhe/ose kontratat e furnizimit me gaz, përfshirë pa u kushtëzuar, tek nderprerja e pabazuar e furnizimit me gaz natyror;
- g) të marrë furnizimin me gaz natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit në vartësi të ligjshmërisë së tij dhe sipas detyrimit të shërbimit publik, afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe rregullave operationale në fuqi, të miratuara nga ERE;
- gj) të informohet për konsumin e tij dhe kostot respektive të gazit natyror, në varësi të pajisjeve matëse me të cilat është furnizuar klienti. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë për klientin.
- h) të marrë informacion për konsumin dhe gjendjen përfundimtare financiare, pas ndryshimit të furnizuesit të gazit natyror, jo më vonë se njëzet (20) ditë nga ndryshimi i këtij të fundit.

11.3. Klienti fundor duhet të zotërojë të drejta të tjera, sipas Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të këtyre Rregullave, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe kontratës së furnizimit me gaz.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

11.4. Në çdo rast, kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhur me furnizuesin nuk kufizojnë të drejtën e Klientit për të ndryshuar furnizuesin për shkak të kontratës afat-gjate. Furnizuesi aktual është i detyruar të furnizojë klientin fundor, deri në mbarimin e procedurës për ndryshimin e furnizuesit.

11.5. Klientët e mëdhenj jo-familjarë mund të bien dakord për furnizimin me gaz natyror me një ose me shumë furnizues për të njëjtën pike matje për të siguruar kërkesat me gaz natyror, por vetëm në rastet kur një nga furnizuesit e kontraktuar autorizohet të veprojë si furnizues përgjegjës për balancimin, bazuar në marrëveshjen respektive midis klientit dhe furnizuesit të tij të kontraktuar.

### **Neni 12** **Detyrimet e Klientit Fundor**

12.1. Klienti fundor është i detyruar:

- a) të përzgjedh furnizuesin i cili është i autorizuar të furnizojë gaz natyror për klientët në Shqipëri;
- b) para se të fillojë konsumin e gazit natyror, të sigurojë që ambjentet e tij ose objektet e tjera janë të lidhura me rrjetin e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së gazit natyror, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në kodin e rrjetit në fuqi, dhe të lidh kontratat, siç përcaktuar në pikën 4.5 të kësaj rregulloreje;
- c) të sigurojë përdorimin siç duhet të ambjenteve të tij ose objekteve të tjera të cilat konsumojnë gaz natyror sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi si dhe kontratat e lidhura për furnizimin e gazit natyror;
- ç) të aplikojë për regjimet dhe/ose kërkesat për konsumin e gazit natyror, siç përcaktohet në kontratat e furnizimit me gaz, në rastet kur kjo aplikohet;
- d) të sigurojë deklarimin e rregullt dhe në kohë të konsumit të gazit natyror dhe pagesave për gazin natyror të konsumuar, siç kërkohet sipas akteve ligjore në fuqi si dhe të kontratës së furnizimit me gaz;
- dh) të sigurojë instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të tij ose objekteve të tjera të cilat konsumojnë gaz natyror për të mos shkaktuar ndonjë kërcënim për funksionimin e sigurtë të sistemit të gazit natyror dhe të ambjenteve ose objekteve të tjera të gazit natyror nga persona të tjerë dhe për të mos shkaktuar shqetësime të cilat kërcënojnë sigurinë e furnizimit me gaz natyror;
- e) të sigurojë akses të pakufizuar në ambjentet e tij dhe pajisjet e matjes për personat e autorizuar të operatorit të sistemit aktual dhe të furnizuesit;
- ë) të parandalojë pajisjet e matjes të cilat janë brenda ndërtesës, nga aksesi i pa autorizuar;
- f) të rimbursojë furnizuesin për dëmet e shkaktuara për shkak të detyrimeve të pa zbatuara nga klienti fundor, sipas akteve ligjore në fuqi dhe/ose kontratës së furnizimit me gaz;



## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

g) ti ofrojë operatorit të sistemit aktual dhe furnizuesit informacion të përshtatshëm në lidhje me funksionimin e ambienteve ose objekteve të tjera të klientit fundor si dhe pajisjet e matjes, përfshirë, por pa u kufizuar, në keqfunksionim.

12.2. Klienti fundor duhet të kryejë detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të këtyre rregullave, akteve të tjera ligjore në fuqi si dhe të kontratës së furnizimit me gaz.

### **PJESA E KATËRT**

#### **ÇMIMI I GAZIT NATYROR DHE PAGESAT**

##### **NENI 13**

##### **Çmimi i Gazit Natyror**

13.1. Bazuar në legjislacionin në fuqi i cili rregullon Sektorin e Gazit Natyror, çmimi i tij për klientët është i pa-rregulluar dhe duhet të përcaktohet sipas kontratave të furnizimit me gaz të lidhur midis klientit dhe furnizuesit të zgjedhur prej tij, përveç rasteve të paraqitura në pikën 10.3 të kësaj Rregulloreje. Çmimi, përbërësit e tij, struktura e çmimit i jepen klientit në faturën e tij të konsumit të gazit natyror.

13.2. Ndryshimet e çmimeve për Gazin Natyror bëhen nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët. Furnizuesi në çdo rast informon klientin me shkrim për ndryshimin e çmimit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para aplikimit të çmimeve të reja, siç përcaktuar në pikën 7.1 të kësaj rregulloreje.

13.3. Tarifat e gazit natyror në rastet e furnizimit të mundësisë së fundit të shërbimit të furnizimit me gaz natyror sipas detyrimit të shërbimit publik, siç parashikohet në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të rregullave operacionale në fuqi, të miratuara nga ERE, duhet të përlllogariten, përcaktohen dhe aplikohen në përputhje me metodologjinë e miratuar nga ERE.

##### **NENI 14**

##### **Pagesa dhe Afati për kryerjen e saj**

14.1. Klienti duhet të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën periodike të konsumit të gazit natyror dhe sipas rastit mund të jetë edhe kamatvonesa përkatëse, jo më vonë se dita e fundit kalendarike e afatit të përcaktuar në marrëveshjen midis palëve. Në çdo rast, afati për pagesat duhet të jetë jo më vonë se data 25 e muajit aktual për klientët familjarë dhe dhjetë (10) ditë pune pas datës së lëshimit të faturës për të gjithë klientët e tjerë.

14.2. Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës të gazit natyror me një nga mundësitë që Furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në Zyrat e Furnizuesit, bankave, zyra postare, apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

14.3. Të gjitha pagesat sipas këtyre kushteve duhet të përmbajnë të dhënat, siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e gazit natyror, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

14.4. Sipas Marrëveshjes me Klientin faturat mund ti dërgohen:

- Klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- Në adresë të një personi të tretë i cili është përcaktuar si pagues nga Klienti sipas pëlqimit të tij.

14.5. Në të gjitha rastet, Klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave të dërguara, sipas pikës 14.4 të këtij neni. Në rast se Klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mos pagesat e faturave.

14.6. Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga Klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, Furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të Klientit, dhe shuma përkatëse, të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të Klientit.

### **NENI 15**

#### **Kamatëvonesa për pagesë të vonuar**

Pas kalimit të afatit të pagesës së caktuar në kontratën mes palëve, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontratë, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë, e cila në çdo rast nuk mund të jetë më e lartë se vlera e vetë faturës.

### **NENI 16**

#### **Pasojat e Mospagesës**

Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda afatit të përcaktuar në kontratë, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara, në adresën e përcaktuar në kontratë.

**PJESA E PESTË**  
**SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PROCESIT TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR**

**NENI 17**

**Leximi i Matësit dhe Faturimi**

17.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të gazit natyror të Klientit për një periudhë kohore, siç rënë dakort në kontratën e nënshkruar nga palët dhe do ti dërgojë Klientit në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të gazit natyror, brenda 10 ditëve nga data e leximit dhe në çdo rast jo më vonë se procedura e specifikuar në pikën 17.3 të këtij neni.

17.2 Çdo faturë e gazit natyror duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të Klientit;
- Data e leximit;
- Periudha e faturuar;
- Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Data limit e pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonese;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlera e detajuar e debisë së Klientit;
- Informacione të nevojshme për Kujdesin ndaj Klientit (përfshirë website i kompanisë, numrat e telefonit, e-mail për ankesat, për defektet, sigurëse dhe për ERE-n).

17.3. Furnizuesi do të përgatisë dhe do të nxjerr faturën për konsumin e gazit natyror të klientit fundor gjatë periudhës paraardhëse, sipas temave përkatëse:

- a) Furnizuesit që u shërbejnë klientëve familjarë deri në 5 ditë kalendarike të muajit aktual;
- b) të gjithë furnizuesve, siç dakordësuar në kontratën e furnizimit, por jo më vonë se 20 ditë kalendarike të muajit aktual.

17.4. Fatura duhet të ketë një llogaritje të ndarë për çdo pikë matjeje të klientit fundor.

17.5. Në rastet kur fatura mbulon shërbimin e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes, të siguruar nga operatori i sistemit aktual, siç përcaktuar në pikën 4.6 të kësaj rregulloreje, të gjitha llogaritjet në faturë duhet të jenë të ndara për çdo shërbim të siguruar nga operatori aktual dhe furnizuesi.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

17.6 Furnizuesi do të sigurojë pa pagesë aksesin online të faturës së konsumit për çdo Klient, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të Klientit dhe faturimit.

17.7 Gazi natyror i hedhur në rrjet ose i faturuar të klientët fundor, matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e kodit të Rrjeteve dhe Kodit të Matjes si dhe të legjilacionit në fuqi për metrologjinë. Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

### NENI 18

#### **Faturimi gjatë mosfunksionimit të aparatit matës**

18.1. Faturimi për konsumin e gazit natyror për ditët që Klientit i është hequr aparati matës për shkak të kontrollit periodik me kërkesë të Klientit apo Furnizuesit, ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës, do të bëhet bazuar në vlera reference historike (bazuar në konsumin mesatar të 3 muajve të fundit). Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

18.2. Nëse Furnizuesi nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje përtej këtij afati, do të jetë zero.

### NENI 19

#### **Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të gazit natyror**

19.1. Klienti Fundor ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë Furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të Furnizuesit që lidhet me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon ose në rrugë elektronike.

19.2. Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me Rregulloren e trajtimit të ankesave, të miratuar nga ERE. Kjo Rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e gazit natyror, apo në Zyrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe në faqet elektronike të Furnizuesit apo të ERE-s.

19.3. Në rast se Furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën Klientit brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e mësipërme, apo nëse Klienti nuk është dakort me përgjigjen e dhënë prej Furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë ankesën në ERE, sipas procedurave të përcaktuara në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuara nga ERE.

19.4. Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga Furnizuesi, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit ashtu edhe në gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes. Në çdo rast klienti fundor mund të kërkojë për korrektimin e faturës së publikuar nga furnizuesi jo më vonë se 1 vit nga data e publikimit të faturës respektive.

19.5. Në rast se pas verifikimeve të Furnizuesit rezulton se klienti është mbifaturuar, atëherë Furnizuesi:

- i. anullos faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrektuar;
- ii. në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën pasardhëse të Klientit.

19.6 Në rast të mos kompensimit brenda afatit të përcaktuar më sipër, Furnizuesi duhet të kompensojë Klientin, sipas përcaktimeve në kontratën e lidhur mes palëve, për çdo ditë vonesë, mbi vlerën e diferencës për tu korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

### **NENI 20**

#### **Instalimi dhe pronësia**

20.1 Operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së, si dhe linjat direkte, janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve, sipas regjistrimeve të aparateve matëse në instalimet e tyre përkatëse të gazit natyror. Sistemi i matjes së instaluar pranë klientëve është pronë e operatorëve respektivë.

20.2 Me miratimin e ERE-s, operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së mund të kontraktojnë operatorë të pavarur për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose shërbimeve të leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

20.3. Sasia e gazit natyror e transportuar, e depozituar, e furnizuar apo e shpërndarë te klientët fundorë, nëpërmjet instalimeve dhe impianteve të operatorëve të sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit, të terminaleve të GNL-së, si dhe në linjat direkte, matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me rregullat specifike matëse, të përcaktuara në Kodin e Rrjetit, rregullat e përdorimit për sistemin e depozitimit të gazit, rregullat

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

e përdorimit për terminalin e GNL-së, sikurse përcaktohet në nenet 44, 55, 67 dhe 74, të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe në legjislacionin në fuqi, lidhur me fushën e metrologjisë.

20.4. Operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së janë të detyruar t’i mundësojnë në çdo kohë klientit leximin e aparateve matëse të gazit natyror. Ky shërbim do të sigurohet pa pagesë.

20.5. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit, të terminaleve të GNL-së dhe në linjat direkte, me shpenzimet e vet operatorëve.

20.6. Matësi dhe/ose sistemi matës i gazit natyror, pas instalimit, duhet të vuloset nga operatori i sistemit, me vulë të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Matësit e gazit natyror duhet të jenë në përputhje me legjislacionin për instrumentet matëse.

20.7. Klasa e saktësisë së matësve të gazit natyror përcaktohet në Kodin e Matjes, të miratuar nga ERE.

20.8. Në rast kur në veprimtarinë e matjes implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë, implementimi i tyre është subjekt i një vlerësimi paraprak të kryer nga operatorët e sistemit, që duhet të marrë në konsideratë kostot, përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, sigurinë teknike, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të qytetarëve. Ky vlerësim miratohet nga ERE.

### **NENI 21**

#### **Kontrolli i sistemit matës**

21.1. ERE kërkon prej operatorëve të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave depozituese dhe të terminaleve të GNL-së të kryejnë, në mënyrë periodike, kontrole të aparateve matëse për çdo instalim të gazit natyror, si dhe për çdo kategori klientësh.

21.2. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar.

21.3 Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

- 21.4 Gjatë përcaktimit të periodicitetit të verifikimit të matësve, ERE merr edhe mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.
- 21.5. Verifikimi i matësve të gazit natyror kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik, i autorizuar për këtë qëllim, sipas ligjeve në fuqi.
- 21.6. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar.
- 21.7. Gjatë procesit të verifikimit të matësve të gazit natyror nga DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar, duhet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i operatorit të sistemit përkatës dhe klienti fundor. DPM miraton procedurat e verifikimit të matësve të gazit natyror.
- 21.8. Kur, pas verifikimit, konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti fundor, shpenzimet për verifikimin, riparimin ose zëvendësimin e matësit mbulohen nga operatori i sistemit përkatës. Në këtë rast bëhen përlllogaritjet përkatëse të sasisë së gazit të faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës, duke përcaktuar edhe mënyrën e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
- 21.9. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të tij nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.
- 21.10 Nëse ka prova se matësi është dëmtuar ose në të është ndërhyrë nga ana e klientit fundor, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi. Çdo ndërhyrje në sistemin e matjes dhe matësit të gazit natyror, nga persona të paautorizuar, është e ndaluar dhe ndëshkohet sipas akteve ligjore në fuqi.
- 21.11. Matesi mund të modifikohet, hiqet ose zhvendoset nga Furnizuesi ose Operatori i rrjetit në rastin e miratimit të standardeve të reja të sigurisë ose kur, për ndryshimet mjedisore ose Matesi është në vende që konsiderohen të rrezikshme ose të papërshtatshme.
- 21.12. Në çdo rast zëvendësimi i një matësi, do të shoqërohet me një procesverbal mbi shkakun e heqjes/largimit të matësit dhe të çdo parregullsi të konstatuar.

## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

21.13. Operatori i Shpërndarjes ose i Transmetimit të gazit natyror mund të kryejë kontrolle mbi instalimet dhe pajisjet e rrjetit shpërndarës, nëse ato ndodhen brenda vendndodhjeve të Klientit - me përjashtim të pronave të bashkëpronësisë ose të destinuara për përdorim të përbashkët.

21.14 Në çdo rast, Operatori i Shpërndarjes ose i Transmetimit të gazit natyror do të duhet të njoftojë Klientin, përveç rasteve të urgjencës për të provuar sigurinë dhe për të shmangur abuzimet. Në varësi të asaj që konkludohet nga kontrolli i matësit, Furnizuesi do të bëjë saktësimet dhe rilogaritjet për të gjitha konsumin e gazit të regjistruara në mënyrë të pasaktë.

### NENI 22

#### **Furnizimi dhe karakteristikat e Gazit Natyror**

22.1. Furnizuesi do të sigurojë furnizimin e pandërprerë dhe me cilësi të gazit natyror. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin me gaz natyror subjekteve dhe klientëve të tjerë fundor në rastet e mëposhtme:

- a. Për shkaqe të forcës madhore - ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit;
- b. Ndërprerje për shkak të urdhërave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- c. Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;
- d. Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmetimit të Gazit Natyror, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit;
- e. Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të tubacioneve dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes dhe Transmetimit të Gazit Natyror.
- f. Veprimet e palejuara të klientit fundor në shkeljen e kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe/ose në Kontratën e furnizimit me Gaz Natyror.
- g. Bazuar në aplikimin e klientit fundor, sipas pikes 8.10
- h. Mungesa e përgjithshme e gazit natyror në sistem pas deklarimit të situatës emergjente nga autoriteti kompetent i Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.



## MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 161, DATË 09.07.2018

- 22.2. Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet e parashikuara në gërmat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”, “h” të pikës 22.1 të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në gërmat “d” dhe “e” të pikës 22.1, Furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren “Për Kushtet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Gazit Natyror”, të miratuar nga ERE.
- 22.3. Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren “Për Kushtet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Gazit Natyror”, Furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e Klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuar në Rregulloren e mësipërme.
- 22.4. Në asnjë rast, përfitimi i kompesimit nga ana e Klientit, kur plotësohen kushtet e pikës 22.3 të sipërpërmendur, nuk e përjashton të drejtën e tij për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.
- 22.5. Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë, sipas Kodit të Shpërndarjes së Gazit Natyror, me devijimet e lejuara, të përcaktuara sipas Rregullores për Kushtet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes.
- 22.6. Përcaktimi i dëmit efektiv i shkaktuar Klientit në rastet e pikës 22.3 të këtij neni, bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.
- 22.7. Klienti fundor duhet të bëjë ankesë lidhur me ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror, sipas temave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror”.
- 22.8. Pezullimi i furnizimit dhe dorëzimi fizik i gazit natyror tek klienti fundor, aty ku është e rëndësishme, rikyçja e objekteve të klientit ose objekteve të tjera në rrjetin e gazit natyror do të zbatohet sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në kodin e rrjetit në fuqi.

**PJESA E GJASHTË  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 23**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

23.1 Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s konform ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e Gazit Natyror" dhe "Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror" dhe pranë gjykatës civile për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

23.2. Ankesat e klientëve fundorë duhet të trajtohen nga Furnizuesi, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuara nga ERE.

**NENI 24**

**Amendimi i rregullores**

Këto rregulla janë objekt rishikimi, me vendim të Bordit të ERE-s, sipas Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s.

**Neni 25**

**Konfidencialiteti**

25.1. Furnizuesi duhet të sigurojë mbrojtjen e informacionit konfidencial ose të informacionit të ndjeshëm tregtar marrë nga klientët ose palët e tjera që kryejnë detyrat e tyre sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore. Detyrimi i konfidencialitetit duhet të jepet sipas kërkesave të vendosura në Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" si dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi.

25.2. Klienti fundor do të mbajë të dhënat në lidhje me kontratën e furnizimit me gaz, llogaritjet dhe faturat e ofruara nga furnizuesi dhe të dhënat e matjes si informacion konfidencial, sipas akteve ligjore në zbatim dhe kontratës së furnizimit me gaz. Ky informacion mund të shpërndahet vetëm kur të kërkohet nga ligji dhe/ose kontrata e furnizimit me gaz.

**NENI 26**  
**Zbatimi dhe përgjegjësitë**

26.1. Këto rregulla duhet të aplikohen tek të gjithë furnizuesit që operojnë dhe klientët fundorë të cilët banojnë ose janë të regjistruar, ose ushtrojnë aktivitetet e tyre tregtare brenda territorit Shqiptar.

26.2. Furnizuesit e mundësisë së fundit dhe furnizuesit sipas detyrimit të shërbimit publik duhet ti zbatojnë këto rregulla sipas afateve dhe kushteve të veçanta të përcaktuara në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe të rregullave operacionale të miratuara nga ERE.

26.3. Me hyrjen në fuqi të këtyre Rregullave, por jo më vonë se dy (2) muaj, operatorët e sistemit dhe furnizuesit duhet të shqyrtojnë aktet e tyre procedurale të miratuara ose dokumentat e brendshëm dhe duhet ti harmonizojnë ato me kërkesat e këtyre Rregullave.

26.4. Kërkesa për harmonizimin, sipas pikës 26.3 të këtij neni, përfshin pajtueshmërinë e detyrueshme të formatit dhe përmbajtjes së kontratës së furnizimit me gaz e cila do të aplikohet nga furnizuesi sipas këtyre Rregullave dhe politikave të biznesit në lidhje me furnizimin me gaz natyror dhe sjelljes në lidhje me klientët dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

26.5. Aplikimi i duhur dhe zbatimi i këtyre Rregullave duhet të sigurohet, monitorohet dhe mbikqyret nga ERE brenda fushëveprimit të saj.

26.6. Shkelja e kërkesave të këtyre Rregullave ose çdo shkelje tjetër mund të shkaktojë përgjegjësinë e palës fajtores sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe/ose akteve të tjera ligjore në fuqi.

**NENI 27**  
**Hyrja në fuqi**

Këto Rregulla hyjnë në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.